

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 114 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 117, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "HEC "Malind 1", "Malind 2" dhe "Malind 3" Çorovodë, Skrapar-* subjekti "KRESHOVA" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "GEN- RED" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "HEC "Malind 1", "Malind 2" dhe "Malind 3" Çorovodë, Skrapar-* subjekti "KRESHOVA" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "GEN- RED" sh.p.k.
2. Subjekti "KRESHOVA" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit, për ndërtimin e "HEC "Malind 1", "Malind 2" dhe "Malind 3" Çorovodë, Skrapar si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO